



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**  
**K.P.P. 724/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.10.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

**Objekt:**

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “B-93” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-73375-06-05-2018, me objekt: “Mirëmbajtje me performancë Marikaj (kufi TR, e vjetra) - Kodër Rrashbull, Kodër Rrashbull - k/NISH Tulla - Shkozet, Katër Rrugët - Pjezë, Durrës (stac. fundit) - Bishti Pallës, Deg. Fllakë (Xhafzotaj) – Radiostacion - Katund i Ri, Katër Rrugët - Shijak, Shijak - Maminas, Shijak - Gjepalaj (K/Komunë), Plepa (mbik) - Përroi i Agait (kufi Dr/Kj) (paralele dj.), Përroi Agait (kufi Dr/Kj) - Mbik. hyrje Kavajë (paralele dj), K/Rr. Nac. Nr. 4 (Luz i vogël) - Spille (Plazh), Bishti i Zhurit - Qendër Rrogozhinë - Dalje Rrogozhinë, Qendër Rrogozhinë - Ura e Shkumbinit (ura e vjetër), K/Rr. Nr.2 (Shkozet) - Porto Romano (Loti 1), ByPass Plepa - Kavajë - Rrogozhinë (Loti 6, 7, 10) (112.52 km) (Kontrata 4)”, me fond limit 34.607.032 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Qëndror, Tiranë.

**Ankimues:**

“B-93” sh.p.k.  
Lagja “8 Shkurti”, Rruga “Andon Doro”, Fier

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Rajonit Qëndror, Tiranë  
Rruga “Princ Vidi”, nr .18/3, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 06.06.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-73375-06-05-2018, me objekt: “Mirëmbajtje me performancë Marikaj (kufi TR, e vjetra) - Kodër

Rrashbull, Kodër Rrashbull - k/NISH Tulla - Shkozet, Katër Rrugët - Pjezë, Durrës (stac. fundit) - Bishti Pallës, Deg. Fllakë (Xhafzotaj) – Radiostacion - Katund i Ri, Katër Rrugët - Shijak, Shijak - Maminas, Shijak - Gjepalaj (K/Komunë), Plepa (mbik) - Përroi i Agait (kufi Dr/Kj) (paralele dj.), Përroi Agait (kufi Dr/Kj) - Mbik. hyrje Kavajë (paralele dj), K/Rr. Nac. Nr. 4 (Luz i vogël) - Spille (Plazh), Bishti i Zhurit - Qendër Rrogozhinë - Dalje Rrogozhinë, Qendër Rrogozhinë - Ura e Shkumbinit (ura e vjetër), K/Rr. Nr.2 (Shkozet) - Porto Romano (Loti 1), ByPass Plepa - Kavajë - Rrogozhinë (Loti 6, 7, 10) (112.52 km) (Kontrata 4)”, me fond limit 34.607.032 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Qëndror, Tiranë.

II.2. Në datën 09.07.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3 Nga verifikimi në sitemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 26.07.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |   |                               |
|---|-------------------------------|
| 1. “Nika” sh.p.k.                               | 22.177.245 lekë, skualifikuar |
| 2. “B-93” sh.p.k.                               | 25.776.774 lekë, skualifikuar |
| 3. “EuroNdërtimi 2000” sh.p.k.                  | 25.935.199 lekë, skualifikuar |
| 4. “Varaku - E” sh.p.k.                         | 26.859.826 lekë, skualifikuar |
| 5. “Be - Is” sh.p.k.                            | 26.920.231 lekë, skualifikuar |
| 6. “Guri Ndërtim” sh.p.k.                       | 28.967.801 lekë, skualifikuar |
| 7. “Biba X” sh.p.k.                             | 29.769.257 lekë, skualifikuar |
| 8. “Al-Asfalt” sh.p.k.                          | 30.621.211 lekë, skualifikuar |
| 9. “Alko Impex General Construction” sh.p.k.    | 31.443.632 lekë, skualifikuar |
| 10. BOE “RSM Company” sh.p.k. & “Oruçi” sh.p.k. | 33.514.894 lekë, kualifikuar  |
| 11. “Curri” sh.p.k.                             | 35.712.882 lekë, skualifikuar |

II.4. Në datën 26.07.2018, operatori ekonomik “B-93” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

“Shoqeria B – 93 sh.p.k ne permbushje te kriterit teknik, Kamionçine  $\geq 1.5$  ton ka paraqitur, Kontratë Qeraje Nr. 2104 Rep, Nr. 952 Kol datë 27.04.2018, para noterit publik, lidhur ndërmjet palëve Shoqëria ”B – 93 II” sh.p.k në cilësinë e qeradhënësit dhe Shoqërisë ”B – 93” sh.p.k në cilësinë e qeramarrësit me objekt mjetet: Kamionçinë me targë AA653TB me nr shasie ĘF0NXXTTFNBY69360, vertetuar pronesine me lejen e qarkullimit. Gjithashtu në nje procedurë tjeter prokurimi qe zhvillohet ne te njejten date 09.07.2018 , me te njejtin autoritet kontraktor, njëri nga operatorët ekonomikë pjesmarrës ”B – 93 II” sh.p.k (qeradhënësi) ne permbushje te kriterit teknik ka paraqitur, Kamionçinë me targë AA653TB me nr shasie ĘF0NXXTTFNBY69360, vertetuar pronesine me lejen e qarkullimit. Komisioni i Vleresimit te Ofertave , gjykon se i gjendur përballë një kontrate qeraje që kalon të drejtën e disponueshmërisë së të njëjtave mjete, Kamionçinë me targë AA653TB me nr shasie ĘF0NXXTTFNBY69360, vertetuar pronesine me lejen e qarkullimit....., si dhe faktit qe qeradhënësi ”B – 93 II” shpk ka paraqitur po këtë mjet në

pronësi të vetën, ka vendosur skualifikimin e tyre nga procedurat e prokurimit. Autoriteti kontraktor gjendet përballë një dyshimi real i cili nuk e lejon të krijojë tërësisht bindjen dhe besueshmërinë kundrejt operatorëve ekonomikë duke mos njohur realisht se cilit nga operatorët ekonomikë i përket vërtet disponueshmëria faktike përtej asaj ligjore e mjetit. Akoma më tej Komisioni i Vleresimit të Ofertave, gjykon se zgjidhja e një konflikti hipotetikusht të mundshëm, midis operatorëve ekonomikë në lidhje me të drejtën e disponueshmërisë së mjeteve të mesiperm, mund të jetë objekt zgjidhjeje nga organe të tjera kompetente të ngarkuara nga ligji, por kursesi nga autoriteti kontraktor në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Ky i fundit nuk e ka tagrin dhe mundësinë për tu shprehur përtej anës formale mbi vlefshmërinë e kontratës së qerasë. Në vijim të këtij arsytimi Komisioni i Vleresimit të Ofertave gjykon se anjë prej operatorëve ekonomik nuk ka bindur tërësisht autoritetin kontraktor lidhur me plotësimin e kapaciteteve teknike : Kamionçinë me targë AA653TB me nr shasie ĘF0NXXTTFNBY69360, vertetuar pronesine me lejen e qarkullimit.

II.5. Operatori ekonomik “B-93” sh.p.k. në datën 31.07.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

[...] Argumentojmë se: Në kriteret e vecanta të kualifikimit është kërkuar:

2. Si dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, kandidati/ofertuesi duhet të vërtetojë se zotëron :

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA
1.	Mjet Germimi	ne pronesi ose me qera	cope 2
2.	Mjet Transporti vetëshkarkuese	ne pronesi ose me qera	cope 4
3.	Grejder	ne pronesi ose me qera	cope 1
4.	Rrul vibrues	ne pronesi ose me qera	cope 1
5.	Prerese asfalti ( sharre asfalti)	ne pronesi ose me qera	cope 1
6.	Betoniere	ne pronesi ose me qera	cope 1
7.	Asfaltoshtruese	ne pronesi ose me qera	cope 1
8.	Makineri per sperkatje bitumi	ne pronesi ose me qera	cope 1
9.	Mjete per vendosje parmakesh metalik (guardraila)	ne pronesi ose me qera	cope 1
10.	Fabrike Asfaltobetoni	ne pronesi ose me qera ose me kontrate furnizimi	cope 1
11.	Skarifikuese ( freze asfalti )	ne pronesi ose me qera	cope 1
12.	Kamionçine $\geq 1.5$ ton	ne pronesi ose me qera	cope 2
13.	Mjet per vijezim me boje	ne pronesi ose me qera	cope 1
14.	Cilinder vibrues per mbushjen e gropave 1.5 – 2 ton	ne pronesi ose me qera	cope 1
15.	Mjet motorrik per prerjen e bimesise	ne pronesi ose me qera	cope 2

Shoqëria jonë për përmbushjen e kriterëve të vecanta të kualifikimit ka paraqitur në tender mjetet dhe pajisjet teknike si më poshtë:

NË PRONËSI				
Lloji i Mjetit	Targa	Nr. Lejes qarkullimit	Nr. Shasisë	Të tjera
ESKAVATOR	JCB		445428	VERT.ZHDOGANIMI
ESKAVATOR	CATERPILAR		6BL01582	VERT.ZHDOGANIMI
KAMIONCINE	AA 189 IU			
ASFALTOSHTRUESE	TITAN			VERT.ZHDOGANIMI
GREJDER				VERT.ZHDOGANIMI
MAKINERI VJEZIMI				VERT.ZHDOGANIMI
RRUL ME VIBRIM				VERT.ZHDOGANIMI
SHARRE ASFALTI	SM57			VERT.ZHDOGANIMI
BETONIERE				FATURE TATIMORE
BATIPAL				FATURE TATIMORE
FREZE ASFALTI				FATURE TATIMORE
MOTOSHARRE				FATURE TATIMORE
KORRESE BARI				FATURE TATIMORE

ME QERA					
Lloji i Mjetit	Targa e mjetit	Nr. Lejes së qarkullimit të mjetit	Nr. Shasisë së mjetit	Nr. Kont së qerasë (noterisë)	Afati i kontratës së qerasë (Data e fillimit dhe mbarimit)
KAMION	AA674LM			Rep 2104 Kol 952	27/04/2018-27/04/2023
KAMION	AA364 PB			Rep 2105 Kol 953	27/04/2018-27/04/2023
KAMION	AA460 DN			Rep 2103 Kol 951	27/04/2018-27/04/2023
KAMION	AA461 NI			Rep 2102 Kol 950	27/04/2018-27/04/2023
AUTOBITUMATRICE	AA830 LT			Rep. 1107 Kol. 473	02/03/2018 – PA AFAT
KAMIONCINE	Br 0898 B			Rep. 3259 Kol. 1552	06/07/2018 – PERF. I PUNIMEVE
RRUL NGJESHES				Rep. 3259 Kol. 1552	06/07/2018 – PERF. I PUNIMEVE
KONTRATE FURNIZIMI ME ASFALT				Rep. 3186 Kol. 1453	28/06/2018 – PERF. I PUNIMEVE

*Për përmbushjen e kriterit të paraqitjes së kamioncinave më kapacitet  $\geq 1.5$  ton, ne kemi ngarkuar në tender: 1. Kamioncinen me targë AA 189 IU, në pronësi, 2. Kamioncinën me targë BR 0889 B, me kontratë qeraje nr. Rep 3359, nr. Kol 1552 me shoqërinë “Totila” sh.p.k. Të dyja këto kamioncina janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga njësia e prokurimit dhe plotësojnë kriteret teknike për disponimin e kamioncinave  $\geq 1.5$  ton, 2 copë, nga shqyrtimi i dokumentave nga ana e KVO. Kontrata e përmendur nga ju, me nr. 2104 Rep, nr, 952 Kol datë 27.04.2018, para noterit publik, lidhur ndërmjet palëve shoqëria “B-93 II” sh.p.k. në cilësinë e qiradhënsit dhe shoqërisë “B-93” sh.p.k. është paraqitur në tender me qëllim vetëm disponueshmërinë e mjetit kamion me targë AA 674 LM. Kjo kontratë bashkëlidhur ka vetëm dokumentacionin teknik të kamionit AA674LM dhe nuk ka asnjë dokumentacion teknik për vënie në dispozicion të objektit të*

prokurimit, të kamioncionës AA653TB. Kamioncina e përmendur nga ju me targë AA653TB me nr. Shasie XXXXXXXXXXXX nuk është e paraqitur në këtë procedurë si mjet i disponueshëm në realizimin e punimeve të kësaj kontrate. Si pjesë e dokumentave teknike është paraqitur edhe shtojca e disponimit të makinerive për realizimin e kontratës, e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Nëpërmjet kësaj shtojce shoqëria jonë deklaron mjetet të cilat do të jenë të disponueshme për realizimin e kontratës, në përputhje me kriteret teknike të tenderit dhe nëse do të shikojmë këtë shtojcë kamioncina me targë AA653TB me nr shasie XXXXXXXXXXXX nuk është pasqyruar. Pra ky mjet nuk është ngarkuar në tender dhe as është deklaruar I disponueshëm nga shoqëria jonë për këtë procedure, si I tillë ai nuk merret në shqyrtim nga ana e KVO dhe aq më pak të përdoret si arsye skualifikimi. Në këtë kuptim argumentimi i KVO-së se "...krijojë tërësisht bindjen dhe besueshmërinë kundrejt operatorëve ekonomikë duke mos njohur realisht se cili nga operatorët ekonomikë i përket vërtet disponueshmëria faktike përtej asaj ligjore e mjetit" nuk qëndron, pasi faktet janë të qarta, të lexueshme dhe ligjore. Interpretimi që bën KVO është i pasaktë dhe jo në mbështetje dhe në zbatim të ligjit. KVO nuk mund të shqyrtojë një mjet që nuk është pjesë fare e kësaj procedure prokurimi. Gjithashtu nuk ka vend për shprehjen e KVO-së se "...zgjidhja e një konflikti hipotetikusht të mundshëm, midis operatorëve ekonomikë në lidhje me të drejtën e disponueshmërisë së mjeteve të mesiperm, mund të jetë objekt zgjidhjeje nga organe të tjera kompetente..." pasi mjeti AA653TB nuk është objekt i kësaj procedure, nuk është paraqitur në tabelën e disponueshmërisë së mjeteve dhe rrjedhimisht nuk ka vend për konflikte me askënd. Së fundmi theksojmë se marrja e KVO me analizimin e një mjeti që nuk është paraqitur fare në procedurë, ndërkohë që kriteret për kualifikim janë plotësuar me mjetet me targë AA189IU dhe me targë BR 0898B, sic është kërkuar në DST, na bën të dyshojmë se KVO bën skualifikim të qëllimshëm, diskriminues duke shkelur barazinë në tender, në shkelje të hapur të LPP. Ju sjellim në vëmendje nenin 55 të LPP [...]. "B-93" sh.p.k. I plotëson më së miri të gjitha kriteret e vendosura nga njësia e prokurimit si dhe ka paraqitur ofertë ekonomikisht më të favorshme. Kërkojmë nga ana e AK të bëjë rivlerësim të procedurës duke shpallur fituese shoqërinë "B-93" sh.p.k. në respekt të përcaktimeve të LPP dhe dokumentave standarte të tenderit.

II.6. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit pretendon se nuk ka marrë dijeni në lidhje me kthim përgjigjen e autoritetit kontraktor. Ndërkohë që, sipas informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, në datën 06.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, nëpërmjet shkresës me nr. 527/1 prot., duke e refuzuar ankesën.

Ndër të tjera, autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes argumenton si më poshtë vijon:

[...] Konstatohet se asnjë nga mjetet e deklaruara nga operatori ekonomik si kamioncinë, për të cilët ka paraqitur edhe dokumentacionin përkatës, plotëson këtë kapacitet të parashikuar nga autoriteti në DST. Mjeti në pronësi me targë AA 189 IU, i paraqitur nga operatori ankimues si kamioncinë, referuar dokumentit leje qarkullimit të mjetit, në të cilin konstatohen të gjitha të dhënat në lidhje me parametrat e mjetit, ndërmjet të cilave edhe të dhëna mbi identifikimin e mjetit, në nr. Rendor 1, evidentohet kamion, në pjesën Përmbajtja, në nr.rendor 23 dhe 24 janë përkatësisht: masa maksimale e autorizuar (kg) 15000 dhe masa e mjetit bosh (kg) 10600. Mjeti me qira, kontratë noteriale 3359 rep, 1552 kol para noterit publik, më datë 06.07.2018 afati në rast fitimi të tenderit, sa periudha e zgjatjes së objektit, me targë BR0898B, i paraqitur nga operatori ankimues si kamioncinë, referuar dokumentit leje qarkullimit të mjetit, në të cilin konstatohen të gjitha të dhënat në lidhje me parametrat e mjetit, ndërmjet të cilave edhe të dhëna

*mbi identifikimin e mjetit, në nr. Rendor 1, evidentohet kamion, në pjesën Përmbajtja, në nr.rendor 23 dhe 24 janë përkatësisht: masa maksimale e autorizuar (kg) 6600 dhe masa e mjetit bosh (kg) 3520...asnjë nga mjetet e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues nuk i përmbush kushtet e kriteret përsa I takon disponimit të dy mjeteve, Kamioncinë  $\geq 1.5$  ton. [...]*

II.7. Në datën 07.08.2018 operatori ekonomik “B-93” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 554 prot., datë 10.08.2018, protokolluar me tonën në datën 10.08.2018, me objekt “Dërgojmë informacion dhe dokumentacion për procedurën e prokurimit” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “B-93” sh.p.k. për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se: “Për përmbushjen e kriterit të paraqitjes së kamioncinave më kapacitet  $\geq 1.5$  ton, ne kemi ngarkuar në tender: 1. Kamioncinen me targe AA 189 IU, në pronësi, 2. Kamioncinën me targë BR 0889 B, me kontratë qeraje nr. Rep 3359, nr. Kol 1552 me shoqërinë “Totila” sh.p.k. Të dyja këto kamioncina janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga njësia e prokurimit dhe plotësojnë kriteret teknike për disponimin e kamioncinave  $\geq 1.5$  ton, 2 copë, nga shqyrtimi i dokumentave nga ana e KVO”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.8 e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

”8. Si dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, kandidati/ofertuesi duhet të vërtetojë se zotëron:

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONESIA	SASIA
1.	Mjet Germimi	ne pronesi ose me qera	cope 2
2.	Mjet Transporti vetëshkarkuese	ne pronesi ose me qera	cope 4
3.	Grejder	ne pronesi ose me qera	cope 1
4.	Rrul vibrues	ne pronesi ose me qera	cope 1
5.	Prerese asfalti ( sharre asfalti)	ne pronesi ose me qera	cope 1
6.	Betoniere	ne pronesi ose me qera	cope 1
7.	Asfaltoshtruese	ne pronesi ose me qera	cope 1

8.	Makineri per sperkatje bitumi	ne pronesi ose me qera	cope 1
9.	Mjete per vendosje parrakesh metalik (guardraila)	ne pronesi ose me qera	cope 1
10.	Fabrike Asfaltbetoni	ne pronesi ose me qera ose me kontrate furnizimi	cope 1
11.	Skarifikuere ( freze asfalti )	ne pronesi ose me qera	cope 1
12.	Kamionçine $\geq 1.5$ ton	ne pronesi ose me qera	cope 2
13.	Mjet per vijezim me boje	ne pronesi ose me qera	cope 1
14.	Cilinder vibrues per mbushjen e gropave 1.5 – 2 ton	ne pronesi ose me qera	cope 1
15.	Mjet motorrik per prerjen e bimesise	ne pronesi ose me qera	cope 2

*Për mjetet, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit. Kur janë me qira duhet të paraqiten kontratat e qirasë noteriale , faturat tatimore të shitjes, kontratat e shitblerjes ose /dhe aktet e zhdoganimit.*

*Për mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit, ku të specifikohet objekti dhe afati i saj jo më pak se afati i ekzekutimit të objektit të prokurimit. Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit ).*

III.1.2. Në shtojcën e publikuar për modifikimin e dokumentave të tenderit, “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 8 autoriteti kontraktor ka modifikuar kriterin si më poshtë:  
*-Nënpika 2.3.8 e kapacitetit teknik, ishte : “Për mjetet, kur janë në pronësi, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit. Kur janë me qira duhet të paraqiten kontratat e qirasë noteriale, faturat tatimore të shitjes, kontratat e shitblerjes ose /dhe aktet e zhdoganimit. Për mjetet e marra me qira, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit, ku të specifikohet objekti dhe afati i saj jo më pak se afati i ekzekutimit të objektit të prokurimit. Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i vlefshëm i mjetit ).”*

*-Nënpika 2.3.8 e kapacitetit teknik, ndryshohet: “Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit. Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi); çertifikatën e kontrollit teknik; siguracionin e vlefshëm të mjetit dhe kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera që nuk regjistrohen në regjistrat publik, duhet të paraqiten faturat tatimore të shitjes ose / dhe kontratat e shitblerjes ose / dhe aktet e zhdoganimit dhe në rastin e marrjes së tyre me qira/kontratë furnizimi paraqitet dhe kontrata përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi”.*



III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “B-93” sh.p.k., në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

- Deklaratë ”Mbi disponimin e makinerive” e operatorit ekonomik ”B-93” sh.p.k.
- Kontratë Shitblerje Nr.1963 rep., Nr. 931 kol., datë 22.05.2017, për Shitblerje Automjeti, me targë AAXXXIU, ndërmjet shitësit Z.A.S dhe blerësit shoqëria ”B-93” sh.p.k.
  - Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor Kamion me targë AAXXXIU.
  - Leje qarkullimi
  - Certifikatë e kontrollit teknik
  - Siguracionin e mjetit
  - Foto e mjetit
- Kontratë Qeraje Nr.3359 rep., Nr. 1552 kol., datë 06.07.2018, për marrjen me qera të mjetit Kamioncinë, me targë BRXXXXB, ndërmjet qeradhënësit shoqërisë ”Totila” sh.p.k. dhe qeramarrësit shoqëria ”B-93” sh.p.k.
  - Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor BRXXXXB, në emër të shoqërisë ”Totila” sh.p.k..
  - Leje qarkullimi
  - Certifikatë e kontrollit teknik
  - Siguracionin e mjetit
  - Foto e mjetit

III.1.4. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”*

III.1.5. Në nenin 26, pika 8/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

III.1.6. Ndërsa në nenin 26 pika 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.*

III.1.7. Në ligjin Nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 54, pika 1/c, parashikohet:

*“c) automjet për transport të përzier: mjet që ka një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike a me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtusit të mjetit;”*

Ndërsa në pikën 2 të po këtij neni parashikohet: *“Në aktet në zbatim përcaktohen, sipas pajisjeve të tyre shoqëruese, tipat e automjeteve që regjistrohen si automjete për transporte të veçanta dhe si automjete për përdorime të veçanta.”*

III.1.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.9. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, operatori ekonomik “B-93” sh.p.k. rezulton i skualifikuar nga procedura e mësipërme e prokurimit me arsyetimin se *“Shoqëria B – 93 sh.p.k ne permbushje te kriterit teknik, Kamionçine ≥ 1.5 ton ka paraqitur, Kontratë Qeraje Nr. 2104 Rep, Nr. 952 Kol datë 27.04.2018, para noterit publik, lidhur ndërmjet palëve Shoqëria ”B – 93 II” sh.p.k në cilësinë e qeradhënësit dhe Shoqërisë “B – 93” sh.p.k në cilësinë e qeramarrësit me objekt mjetet: Kamionçinë me targë AA653TB me nr shasie ĔFONXXTTFNBY69360, vertetuar pronesine me lejen e qarkullimit. Gjithashtu në nje procedurë tjetër prokurimi qe zhvillohet ne te njejten date 09.07.2018, me te njejtin autoritet kontraktor, njëri nga operatorët ekonomikë pjesmarrës “B-93 II” sh.p.k (qeradhënësi) ne permbushje te kriterit teknik ka paraqitur, Kamionçinë me targë AA653TB me nr shasie WFONXXTTFNBY69360, vertetuar pronesine me lejen e qarkullimit. Komisioni i Vleresimit te Ofertave, gjykon se i gjendur përballë një kontrate qeraje që kalon të drejtën e disponueshmërisë së të njëjtave mjete [...]”* Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin ndër të tjera dokumentacionin e nevojshëm me anë të të cilit të vërtetojnë se disponojnë dy kamionciona me kapacitet  $\geq$  se 1.5 ton.

Në verifikim të përmbushjes së kriterit për mjetin kamioncinë, që është edhe arsyeja e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, rezulton se, operatori ekonomik “B-93” sh.p.k. për këtë kriter ka paraqitur deklaratën mbi disponimin e mjeteve, ku deklaroi që disponon dy kamioncina, me targë AAXXXIU dhe BRXXXXB, si dhe dokumentacionin përkatës për këto dy mjete, konkretisht Kontratën e Shitblerjes Nr.1963 rep., Nr. 931 kol., datë 22.05.2017, për shitblerjen e automjetit, me targë AAXXXIU, si dhe Kontratën e Qerasë Nr.3359 rep., Nr. 1552 kol., datë 06.07.2018, për marrjen me qera të mjetit Kamioncinë, me targë BRXXXXB, ndërmjet qeradhënësit shoqërisë ”Totila” sh.p.k. dhe qeramarrësit shoqëria ”B-93” sh.p.k.

Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, konkretisht, mjeti me targë AAXXXIU, i paraqitur nga ky i fundit në përmbushje të kriterit për mjetin kamioncinë, referuar lejes së qarkullimit, rezulton se, kalon kapacitetin 3.5 ton që parashikohet si kapacitet maksimal për mjetet e transportit të përzier. Sqarojmë se, referuar legjislacionit të fushës përkatëse, si më sipër cituar, konkretisht Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, në nenin 54, pika 1/c të tij parashikohet se në automjetet për transport të përzier

përfshihen mjetet të cilat kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë [...]. Si rrjedhim në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri që duhet të paraqitet dokumentacion për mjetet kamioncina me kapacitet  $\geq 1.5$  tonë, që në kuptim të legjislacionit në fuqi për qarkullimin rrugor këto mjete nuk duhet të tejkalojnë kapacitetin maksimal 3.5 ton, konstatohet se operatori ekonomik ankimues nuk ka arritur të vërtetojë se disponon mjete të tilla duke mos e plotësuar kështu kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për mjetin kamioncinë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “B-93” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-73375-06-05-2018, me objekt: “Mirëmbajtje me performancë Marikaj (kufi TR, e vjetra) - Kodër Rrashbull, Kodër Rrashbull - k/NISH Tulla - Shkozet, Katër Rrugët - Pjezë, Durrës (stac. fundit) - Bishti Pallës, Deg. Fllakë (Xhafzotaj) – Radiostacion - Katund i Ri, Katër Rrugët - Shijak, Shijak - Maminas, Shijak - Gjepalaj (K/Komunë), Plepa (mbik) - Përroi i Agait (kufi Dr/Kj) (paralele dj.), Përroi Agait (kufi Dr/Kj) - Mbik. hyrje Kavajë (paralele dj), K/Rr. Nac. Nr. 4 (Luz i vogël) - Spille (Plazh), Bishti i Zhurit - Qendër Rrogozhinë - Dalje Rrogozhinë, Qendër Rrogozhinë - Ura e Shkumbinit (ura e vjetër), K/Rr. Nr.2 (Shkozet) - Porto Romano (Loti 1), ByPass Plepa - Kavajë - Rrogozhinë (Loti 6, 7, 10) (112.52 km) (Kontrata 4)”, me fond limit 34.607.032 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 09.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Rajonit Qëndror, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1365 Protokolli**

**Datë 07.08.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**